



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 28.08.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Z.Selman Qallapeku**, emërohet anëtar i kuvendit komunal në Gllogoc, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal z.Drin Halilaj.
- II.** Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Selman Qallapeku dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 23.08.2024, Nr.09/1-1284/2024, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal z.Drin Halilaj, i cila ka dhënë dorëheqje, për arsye profesionale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është z.Selman Qallapeku.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë 28.08.2024

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 65 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.08.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Autorizimin e Drejtorit të SKQZ për Nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Aeroportit Ndërkombëtar Limak Kosovë ShA dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

- I. Autorizohet Drejtori i Sekretariatit të KQZ, që të nënshkruaj marrëveshjen e mirëkuptimit ndërmjet Aeroportit Ndërkombëtar Limak Kosovë ShA dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ, për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.08.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhena me nenin 63 nenin 107 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.08.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Tekstit Informues për Përgjigjen Automatike në Sistemin Elektronik për Ndërrimin e Qendrës së Votimit dhe Regjistrimit për Votim Jashtë Kosovës

- I. Miratohet teksti informues për përgjigjen automatike në sistemin elektronik për ndërrimin e qendrës së votimit dhe regjistrimit për votim jashtë Kosovës, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.
- II. Teksti si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.08.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi

Emaili konfirmues për votuesit të cilët kanë aplikuar për regjistrim jashtë Kosovës

I/ E nderuar (personalizuar me emrin dhe mbiemrin e votuesit/es)

(shembull: I nderuar Lirik Krasniqi)

Ju njoftojmë se kemi pranuar kërkesën tuaj për regjistrim si votues jashtë Kosovës. Pas shqyrtimit të kërkesës KQZ do t'ju njoftojë për statusin e aplikimit tuaj.

Me nderime

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Rr. Migjeni, nr. 21, 10 000, Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel: + 383 38 213 100

Poštovani/a (personalizuar me emrin dhe mbiemrin e votuesit/es)

(shembull: I nderuar Lirik Krasniqi)

Obaveštavamo vas da smo primili vaš zahtev za registraciju kao birač van Kosova. Nakon razmatranja zahteva, CIK će vas obavestiti o statusu vašeg zahteva.

S poštovanjem,

Centralna izborna komisija
Ul. Migjeni, br. 21, 10 000, Priština
Republika Kosovo
Tel: + 383 (0) 38 213 100

Emaili për votuesit që mënyrën e votimit e kanë zgjedhur përmes kutive postare në Kosovë dhe jashtë Kosovës.

I/ E nderuar (personalizuar me emrin dhe mbiemrin e votuesit/es)

(shembull: I nderuar Lirik Krasniqi)

Ju njoftojmë se kërkesa juaj për regjistrim si votues jashtë Kosovës për Zgjedhjet për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me 09.02.2025, është **MIRATUAR**.

Periudha e votimit fillon me datën 09.01.2025 dhe përfundon me datën 08.02.2025.

Hapat për të votuar përmes postës

1. Printoni dëftesën e regjistrimit, të cilën e gjeni të bashkangjitur në këtë email.
2. Printoni fletëvotimin të cilin do ta pranoni përmes emailit apo të cilin mund ta gjeni në ueb faqen e KQZ-së .
3. Pasi të shënoni preferencat tuaj në fletëvotim, paloseni dhe e vendosni në një zarf dhe mbylleni. Në këtë zarf nuk duhet të shënoni asgjë, as emrin as ndonjë adresë.
4. Zarfën me fletëvotim, së bashku me dëftesën e regjistrimit, i vendosni në një zarf tjetër.
5. Në zarfën kryesor shënoni adresën e kutisë postare të KQZ-së.
6. Ju duhet ta dërgoni zarfën nga shteti ku ju jetoni, në kutinë postare të hapur nga KQZ.

Emri juaj tashmë është vendosur në listën e votuesve jashtë Kosovës, prandaj ju mund të votoni vetëm përmes postës.

Nëse dëshironi të votoni në vendvotim fizikisht në Kosovë, ju mund të çregjistroheni nga votimi jashtë Kosovës, duke dorëzuar kërkesën tuaj deri me datën 27.12.2024, në e-mail adresën: kundershtimi.vjk@kqz-ks.org, dhe bashkangjitur dëftesën e regjistrimit të nënshkruar dhe një fotografi tuajën, ku mbani në dorë dokumentin identifikues.

Me nderime,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Rr. Migjeni, nr. 21, 10 000, Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel: + 383 (0) 38 213 100

Poštovani/a (personalizuar me emrin dhe mbiemrin e votuesit/es)
(shembull: I nderuar Lirik Krasniqi)

Obaveštavamo Vas da je ODOBREN Vaš zahtev za registraciju kao birača van Kosova za izbore za Skupštinu Republike Kosovo koji će se održati 09.02.2025.
Period za glasanje počinje 09.01.2025. i završava se 08.02.2025.

Koraci za glasanje putem pošte

1. Odštampajte potvrdu o registraciji koja je priložena ovom e-mailu.
2. Odštampajte glasački listić koji ćete dobiti putem e-maila ili koji možete pronaći na veb stranici CIK-a.
3. Nakon što označite vaše izabranike na glasačkom listiću, preklopite ga i stavite u kovertu i zatvorite. Na ovoj koverti ne treba da upišete ništa, ni ime ni adresu.
4. Stavite kovertu sa glasačkim listićem zajedno sa potvrdom o registraciji u drugu kovertu.
5. U glavnoj koverti upišite adresu poštanskog sandučeta CIK-a.
6. Morate poslati kovertu iz zemlje u kojoj živite u poštansko sanduče koje otvori CIK.

Vaše ime je već stavljeno na birački spisak van Kosova, tako da Vi možete glasati samo putem pošte.

Ukoliko želite da glasate fizički na biračkom mestu na Kosovu, možete se odjaviti sa glasanja van Kosova, podnošenjem zahteva do 27.12.2024. godine na e-mail adresu: kundershtimi.vjk@kqz-ks.org i prilaganjem potpisane potvrde o registraciji i vaše fotografije na kojoj držite u ruci identifikacioni dokument.

S poštovanjem,

Centralna izborna komisija
Ul. Migjeni, br. 21, 10 000, Priština
Republika Kosovo
Tel: + 383 (0) 38 213 100

Emaili për votuesit që mënyrën e votimit e kanë zgjedhur përmes përfaqësive diplomatike.

I/ E nderuar (personalizuar me emrin dhe mbiemrin e votuesit/es)

(shembull: I nderuar Lirik Krasniqi)

Ju njoftojmë se kërkesa juaj për votim në Përfaqësinë Diplomatike (emri i përfaqësisë nga sistemi) për Zgjedhjet për Kuvend të Republikës së Kosovës, është **MIRATUAR**.

Dita e votimit në Përfaqësi Diplomatike është dita e shtunë, me datë 08.02.2024, nga ora 07:00 deri në ora 19:00.

Ditën e votimit, sigurohuni të keni me vete njërin nga dokumentet identifikuese (letërnjoftim, pasaportë apo leje e vozitjes) të Republikës së Kosovës.

Emri juaj tashmë është vendosur në listën e votuesve jashtë Kosovës, prandaj ju mund të votoni në përfaqësinë diplomatike të cilën e keni zgjedhur.

Nëse dëshironi të votoni në vendvotim fizikisht në Kosovë, ju mund të çregjistroheni nga votimi jashtë Kosovës, duke dorëzuar kërkesën tuaj deri me datën 27.12.2024, në e-mail adresën: kundershtimi.vjk@kqz-ks.org, dhe bashkangjitur dëftesën e regjistrimit të nënshkruar dhe një fotografi tuajën ku mbani në dorë dokumentin identifikues.

Me nderime,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Rr. Migjeni, nr. 21, 10 000, Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel: + 383 (0) 38 213 100

Emaili për votuesit që mënyrën e votimit e kanë zgjedhur përmes përfaqësive diplomatike. Gjuhe serbe

I/ Poštovani/a (personalizuar me emrin dhe mbiemrin e votuesit/es)

(shembull: I nderuar Lirik Krasniqi)

Obaveštavamo Vas da je ODOBREN Vaš zahtev za glasanje u Diplomatskom predstavništvu (naziv predstavništva iz sistema) za Izbore za Skupštinu Republike Kosovo.

Dan za glasanje u Diplomatskom predstavništvu je subota, 08.02.2024, od 07:00 do 19:00 časova.

Na dan glasanja, osigurajte se da imate sa sobom jedan od identifikacionih dokumenata (ličnu kartu, pasoš ili vozačku dozvolu) Republike Kosovo.

Vaše ime je već stavljeno na birački spisak van Kosova, tako da možete glasati u diplomatskom predstavništvu koje ste izabrali.

Ukoliko želite da glasate fizički na biračkom mestu na Kosovu, možete se odjaviti sa glasanja van Kosova, podnošenjem zahteva do 27.12.2024. godine na e-mail adresu: kundershtimi.vjk@kqz-ks.org i prilaganjem potpisane potvrde za registraciju i vaše fotografije na kojoj držite u ruci identifikacioni dokument.

S poštovanjem,

Centralna izborna komisija
Ul. Migjeni, br. 21, 10 000, Priština
Republika Kosovo
Tel: + 383 (0) 38 213 100

E-maili njoftues për votuesit që janë refuzuar

I/ E nderuar (personalizuar me emrin dhe mbiemrin e votuesit/es)

(shembull: I nderuar Lirik Krasniqi)

Ju njoftojmë se kërkesa juaj për regjistrim është **REFUZUAR**, për arsye se ju: (kjo duhet të lidhet me arsyet e refuzimit)

Ju mund të përsëritni kërkesën për regjistrim dhe të bashkëngjitni dokumentet e nevojshme për të përmbushur kërkesën në përputhje me udhëzimet.

Në rast se ju mendoni se kërkesa juaj është refuzuar në mënyrë të pa drejtë, ju keni të drejtë të bëni kundërshtimin administrativ. Këtë mund ta bëni deri me datën 27.12.2024, duke dërguar fotografinë tuaj me dokument identifikues në dorë dhe pretendimet tuaja, në e-mail adresën: kundershtimi.vjk@kqz-ks.org.

Me nderime,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Rr. Migjeni, nr. 21, 10 000, Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel: + 383(0)38 213 100

Poštovani/a (personalizuar me emrin dhe mbiemrin e votuesit/es)

(shembull: I nderuar Lirik Krasniqi)

Obaveštavamo Vas da je Vaš zahtev za registraciju ODBIJEN, jer Vi: (ovo treba da se odnosi na razloge odbijanja)

Možete ponovo da podnesete zahtev za registraciju i priložite potrebnu dokumentaciju da ispunite zahtev u skladu sa uputstvima.

Ukoliko smatrate da je vaš zahtev nepravedno odbijen, imate pravo da uložite administrativni prigovor. To možete učiniti do 27. Decembra 2024, slanjem vaše fotografije sa ličnim dokumentom u ruci i vaših žalbenih navoda, na e-mail adresu: kundershtimi.vjk@kqz-ks.org.

S poštovanjem,

Centralna izborna komisija
Ul. Migjeni, br. 21, 10 000, Priština
Republika Kosovo
Tel: + 383(0)38 213 100

E-maili njoftues për votuesit që kërkesa e tyre është anuluar

I/ E nderuar (personalizuar me emrin dhe mbiemrin e votuesit/es)

(shembull: I nderuar Lirik Krasniqi)

Ju njoftojmë se kërkesa juaj për regjistrim si votues jashtë Kosovës, është **ANULUAR**.

Në rast se ju mendoni se kërkesa juaj është refuzuar në mënyrë të pa drejtë, ju keni të drejtë të drejtë ankesë. Të drejtën e ankesës mund ta ushtroni deri me datën 27 dhjetor 2024, duke dërguar fotografën tuaj me dokument identifikues në dorë dhe pretendimet tuaja, në e-mail adresën: kundershtimi.vjk@kqz-ks.org.

Me nderime

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Rr. Migjeni, nr. 21, 10 000, Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel: + 383(0)38 213 100

Poštovani,

Obaveštavamo vas da je vaš zahtev za registraciju kao birač van Kosova **PONIŠTEN**.

Ukoliko smatrate da je vaš zahtev nepravedno poništen, imate pravo da uložite administrativni prigovor. To možete učiniti do 27. Decembra 2024, slanjem vaše fotografije sa ličnim dokumentom u ruci i vaših žalbenih navoda, na e-mail adresu: kundershtimi.vjk@kqz-ks.org

Centralna izborna komisija
Ul. Migjeni, br. 21, 10 000, Priština
Republika Kosovo
Tel: + 383(0)38 213 100



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 8 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 3 dhe nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr. 03/2024 Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.08.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Raportit të Listës Preliminare të Votueseve

- I. Miratohet Raporti i listës preliminare të votueseve, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.
- II. Raporti si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.08.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E KOSOVËS

9 SHKURT 2025

RAPORT
LISTA PRELIMINARE E VOTUESVE

1. Hyrje

Në përputhje me Rregulloren Zgjedhore 03/2024 për Krijimi, Kundërshtimi dhe Konfirmimi i Listës së Votuesve, paragrafi 6 i nenit 3 Divizioni i Shërbimit të Votuesve, pas caktimit të votuesve në Qendra të Votimit (QV) ka përgatitur Raportin e Listës Preliminare të Votuesve (LPV), i cili miratohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

Pas aprovimit të raportit, vijojnë aktivitetet për publikimin e listës preliminare të votuesve, periudha për ndërrimin e qendrës të votimit, periudha e aplikimit për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës dhe periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit të listës së votuesve.

2. Raporti i Listës Preliminare të Votuesve

LPV bazohet në Ekstraktin e Regjistrimit Qendror Civil (RQC). Ky ekstrakt është përpiluar nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve (DPD) dhe Departamenti i Gjendjes Civile (DGJC).

Sipas Planit të aktiviteteve për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025, aktiviteti nr. 50 Ekstraktet e para të RQC janë pranuar nga ARC me datën 20 gusht 2024.

LPV për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025, përmban:

- a) 2,047,148 votues, që paraqet një rritje prej 161,700 votuesve, në krahasim me Zgjedhjet e Lokale 2021, të mbajtura me datë 17.10.2021.
- b) Numri i votuesve të rinj që do të votojnë për herë të parë në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, me datën 9 shkurt 2025, është: 209,878 votues, prej tyre:
 - i. 116,001 votues mund të konsiderohen si votues të rinj që pas Zgjedhjeve Lokale, të mbajtura me datën 17.10.2021, kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç do të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025.
 - ii. 46,512 votues mund të konsiderohen si votues të regjistruar për herë të parë në RQC midis dy palë zgjedhjesh, pra votuesit që janë pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës dhe votuesit e regjistruar për votim jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale 2021.
 - iii. 47,365 shtetas nga baza e të dhënave të gjendjes civile.

Numri i votuesve të larguar si të vdekur është 39,665 votues, ndërsa numri i votuesve që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës, pas Zgjedhjeve Lokale 2021 është: 8,513.

Gjithsej, janë 903 qendra të votimit për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025. Në këtë numër nuk përfshihen qendrat e votimit me kusht dhe qendrat e votimit jashtë Kosovës.

Tabelë 1: Dallimi i numrit të votuesve LPV 2025 me LV 2021

Kodi i komunës	Komuna	Numri i votuesve LV 17.10.2021	Numri i votuesve LPV 2025	Dallimi
01	Deçan	39,875	43,151	3,276
02	Gjakovë	113,165	123,658	10,493
03	Glllogoc	54,908	58,559	3,651
04	Gjilan	101,062	109,116	8,054
05	Dragash	39,059	42,932	3,873
06	Istog	47,693	52,550	4,857
07	Kaçanik	32,647	34,911	2,264
08	Klinë	48,305	52,778	4,473
09	Fushë Kosovë	40,289	46,004	5,715
10	Kamenicë	35,161	36,477	1,316
11	Mitrovicë e Jugut	78,546	85,312	6,766
12	Leposaviq	12,707	13,657	950
13	Lipjan	61,045	66,947	5,902
14	Novobërdë	9,367	9,854	487
15	Obiliq	24,539	26,791	2,252
16	Rahovec	57,618	61,618	4,000
17	Pejë	109,051	119,484	10,433
18	Podujevë	83,562	89,153	5,591
19	Prishtinë	195,978	215,370	19,392
20	Prizren	173,359	188,508	15,149
21	Skenderaj	53,479	56,671	3,192
22	Shtime	27,015	28,977	1,962
23	Shtërpcë	12,410	12,995	585
24	Suharekë	66,763	72,512	5,749
25	Ferizaj	111,990	122,236	10,246
26	Viti	48,084	52,031	3,947
27	Vushtrri	71,684	77,340	5,656
28	Zubin Potok	6,443	6,889	446
29	Zveçan	6,879	7,192	313
30	Malishevë	54,018	58,759	4,741
31	Junik	4,527	5,899	1,372
32	Mamushë	4,223	4,800	577
33	Hani i Elezit	8,467	9,014	547
34	Graçanicë	20,671	22,304	1,633
35	Ranillug	4,884	4,975	91
36	Partesh	4,579	4,852	273
37	Klllokot	3,675	3,901	226
38	Mitrovicë e Veriut	17,721	18,971	1,250
TOTALI		1,885,448	2,047,148	+161,700

Tabelë 2: Numri i votuesve të rinj

Kodi Komunal	Komuna	Numri i votuesve të rinj
01	Deçan	4,743
02	Gjakovë	13,593
03	Glllogoc	5,294
04	Gjilan	10,237
05	Dragash	5,325
06	Istog	6,337
07	Kaçanik	3,310
08	Klinë	5,846
09	Fushë Kosovë	4,984
10	Kamenicë	3,182
11	Mitrovicë e Jugut	9,742
12	Leposaviq	1,237
13	Lipjan	7,442
14	Novobërdë	841
15	Obiliq	2,889
16	Rahovec	5,823
17	Pejë	13,040
18	Podujevë	8,990
19	Prishtinë	20,332
20	Prizren	19,024
21	Skenderaj	5,383
22	Shtime	2,711
23	Shtërpcë	1,171
24	Suharekë	7,727
25	Ferizaj	12,174
26	Viti	5,497
27	Vushtrri	7,826
28	Zubin Potok	617
29	Zveçan	553
30	Malishevë	6,269
31	Junik	1,541
32	Mamushë	667
33	Hani i Elezit	867
34	Graçanicë	2,212
35	Ranillug	277
36	Partesh	439
37	Klllokot	291
38	Mitrovicë e Veriut	1,445
TOTALI		209,878

Tabelë 3: Numri i Qendrave të Votimit sipas komunave

Kodi Komunal	Komuna	Numri i qendrave të votimit
01	Deçan	14
02	Gjakovë	36
03	Glllogoc	31
04	Gjilan	38
05	Dragash	33
06	Istog	21
07	Kaçanik	21
08	Klinë	21
09	Fushë Kosovë	16
10	Kamenicë	28
11	Mitrovicë e Jugut	32
12	Leposaviq	18
13	Lipjan	33
14	Novobërdë	18
15	Obiliq	15
16	Rahovec	35
17	Pejë	24
18	Podujevë	47
19	Prishtinë	53
20	Prizren	74
21	Skenderaj	33
22	Shtime	15
23	Shtërpcë	9
24	Suharekë	34
25	Ferizaj	47
26	Viti	31
27	Vushtrri	32
28	Zubin Potok	12
29	Zveçan	6
30	Malishevë	35
31	Junik	1
32	Mamushë	1
33	Hani i Elezit	4
34	Graçanicë	5
35	Ranillug	13
36	Partesh	7
37	Kllokot	3
38	Mitrovicë e Veriut	7
TOTALI		903



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 nenin 107 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.08.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Tekstit Informues për Votuesit për Periudhën e Regjistrimit për Votim Jashtë Kosovës

- I. Miratohet teksti informues për votuesit, për periudhën e regjistrimit për votim jashtë Kosovës, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.
- II. Tekstet si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.08.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

9 shkurt 2025

Të nderuar shtetas të Republikës së Kosovës që jetoni në Diasporë

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ju njofton se ka filluar periudha për aplikim për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës dhe zgjatë deri më **26 dhjetor 2024**.

Nëse jeni shtetas i Republikës së Kosovës dhe jetoni jashtë Kosovës, mund të aplikoni për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës, përmes dy mënyrave:

1. Platformës elektronike: diaspora.kqz-ks.org

- Në këtë platformë, shënoni numrin tuaj personal dhe datën e lindjes.
- Pastaj shtypni butonin "Kërko" ku do të shfaqen disa nga të dhënat tuaja, më pas plotësoni të dhënat e kërkuara, si dhe përcaktoheni për njëren nga mënyrat e votimit:
 - ✓ Përmes Përfaqësive Diplomatike;
 - ✓ Përmes Postës në kutinë postare jashtë Kosovës;
 - ✓ Përmes Postës në kutinë postare në Kosovë.
- Pasi t'i plotësoni të dhënat e kërkuara, ju duhet të ngarkoni kopjen e njërit dokument identifikues të Republikës së Kosovës si: letërnjoftimin, pasaportën ose lejen e vozitjes dhe fotografinë tuaj së bashku me dokumentin identifikues në dorë.

2. Postës në kutinë postare të KQZ-së.

Për më shumë informacione, vizitoni ueb faqën e KQZ-së www.kqz-ks.org, ose kontaktoni në numrin: +383 (0) 38 213 100

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

REGJISTRIMI PËR VOTIM JASHTË KOSOVËS

29 gusht 26 dhjetor 2024



Përmes platformës elektronike duke klikuar në linkun: **"Regjistrohu për votim jashtë Kosovës"**

Regjistrimin mund ta bëni në njërin nga këto mënyra:



Përmes postës në kutinë postare të KQZ-së.

Gjatë periudhës së regjistrimit, ju duhet të zgjidhni njërin nga këto mënyra për të votuar:



Në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës



Përmes postës në një nga kutitë postare të hapura jashtë Kosovës nga KQZ;



Përmes postës në kutinë postare në Kosovë.



diaspora.kqz-ks.org





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 nenin 107 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.08.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Tekstit Informues për Votuesit për Periudhën e Ndërrimit të Qendrës së Votimit dhe Kundërshtimit të Listës Votuese

- I. Miratohet teksti informues për votuesit, për periudhën e ndërrimit të qendrës së votimit dhe kundërshtimit të listës votuese, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.
- II. Teksti si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.08.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Njoftimi për transmetim në TV dhe radio

**ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
9 shkurt 2025**

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ju njofton se ndërrimin e Qendrës së Votimit brenda komunës tuaj mund të bëni deri më **26 dhjetor 2024**.

Ju mund të mësoni qendrën tuaj të votimit dhe nëse dëshironi edhe ta ndryshoni atë, duke e caktuar sa më afër vendbanimit tuaj. Këtë mund ta bëni përmes këtyre dy opsioneve:

1. Përmes platformës online në ueb faqen e KQZ-së: www.kqz-ks.org, duke klikuar në linkun "Gjej dhe ndërro Qendrën e Votimit"; ose
2. Në Zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në komunën tuaj.

Po ashtu, nëse informatat tuaja apo të ndonjë personi që njihni nuk janë të sakta, në Listën Votuese, deri më **28 dhjetor 2024**, ju mund të drejtoheni në Zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në komunën tuaj duke e paraqitur kundërshtimin.

Për më shumë informacione, vizitoni ueb faqën e KQZ-së www.kqz-ks.org, ose kontaktoni këtë linjë ndihmëse pa pagesë: 0800 55 555

Njoftimi për publikim në rrjete sociale

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
9 shkurt 2025

Periudha për ndërrimin e Qendrës së Votimit brenda komunës **29 gusht - 26 dhjetor 2024** dhe për kundërshtimin e pasaktësive në Listën Votuese **29 gusht - 28 dhjetor 2024**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ju njofton se ndërrimin e Qendrës së Votimit brenda komunës tuaj mund të bëni deri më **26 dhjetor 2024**.

Këtë mund ta bëni përmes këtyre dy opsioneve:

1. Platformës elektronike: <http://eomp.kqz-ks.org/VCChangeRequests/Index>, ose
2. Në zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në komunën tuaj.

Po ashtu, nëse informatat tuaja apo të ndonjë personi që njihni nuk janë të sakta, në Listën Votuese, deri më **28 dhjetor 2024**, ju mund të drejtoheni në Zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në komunën tuaj duke e paraqitur kundërshtimin.

Për më shumë informacione, vizitoni ueb faqën e KQZ-së www.kqz-ks.org, ose kontaktoni këtë linjë ndihmëse pa pagesë: 0800 55 555